



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:281655
Datë: 23.02.2024
Numri i dokumentit: 05365989

C – IV. – 15 – 1034

Paditësi :

I R nga fshati M i Komunës së Lipjanit, e të cilin me autorizim e përfaqëson, av. B I nga Prishtina.

Kundër

E paditura :

Agjencia Kosovare e Privatizimit me seli në Prishtinë, Rr. “Dritan Hoxha”, nr.55 , Prishtinë.

Objekti i çështjes : Kompensimi i pagave të pa paguara.

Për: Palët

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), me gjykatësin e vetëm, Agron Hoxhaj, me **dt.23.02.2024**, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit, I R nga fshati M i Komunës së Lipjanit e paraqitur kundër të paditurës, Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë lidhur me Vendimin, PRN169-0010 e dt.14.05.2015 të Autoritetit të Likuidimit (AL) të Agjencisë së Kosovare të Privatizimit (AKP) me seli në Prishtinë për Ndërmarrjen Shoqërore (NSh), “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim) dhe i njëjti Vendim, **VËRTETOHET si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Rrethanat Faktike dhe Procedurale:

Me 10 qershor 2015, paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar të tij, pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK), ka parashtruar ankesën kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit të AKP-së, PRN169-0010 të dt.14.05.2015, e me të cilin i është refuzuar si e pavlefshme kërkesa për kompensimin e pagave të pa paguara për periudhën 01.01.1992 –

11.08.2014, në shumë prej 15.470.00 euro + 10 % kamatë, tani në shumë të përgjithshme 17.017.00 euro, dhe atë për shkak konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me kërkesë që të miratohet në tërësi e bazuar ankesa e paditësit dhe të shfuqizohet Vendimi, PRN169-0010 i dt.14.05.2015 lidhur me NSH “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), të obligohet e paditura që në emër të pagesës së pagave të papaguara për periudhën kohore 01.01.1992-11.08.2014, ti paguaj paditësit në shumë të përgjithshme prej 17.017.00 euro dhe shpenzimet e përfaqësimit në bazë të Tarifës së avokatëve në shumë prej 104, dhe të gjitha shpenzimet tjera deri në fund të procedurës.

Pala paditëse parashtresën e ka titulluar si “ankesë” mirëpo gjykata të njëjtën e konsideron si padi në bazë të nenit 35 par.1 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, e cila dispozitë bënë trajtimin e barabartë të parashtresave me të cilat bëhet “*nisja e procedurave*” pranë Dhomës së Posaçme, pavarësisht faktit se a quhen padi, kërkesa apo ankesa.

Paditësi - ankuesi në këto parashtresa të paraqitura në mes tjerash ka theksuar se ka themeluar marrëdhënien e punës me të paditurën me dt.09.05.1987, në pozitën rojtar, dhe se për arsye të vendosjes së masave të dhunshme paditësit i është ndërprerë marrëdhënia e punës me dt.30.11.1993, dhe se me dt. 11.08.1999, NSH “Rekreaturs”, ka mbajtur mbledhjen në të cilën Ismail Ramadani, u zgjodh anëtarë i Komisionit të kësaj ndërmarrje për pranim – dorëzim e detyra të drejtorit dhe se të njëjtën dt. 11.08.1999 Tubimi i punëtorëve të NSH ka mbajtur mbledhjen lidhur me shqyrtimin e gjendjes së ndërmarrjes pas luftës dhe gjetjen e mundësisë për vazhdimin e veprimtarisë afariste, për zgjedhjen e drejtorit të ri, miratimin e vendimit për anulimin e të gjitha akteve normative dhe veprimeve juridike të udhëheqjes së dhunshme të ndërmarrjes nga dt. 31.08.1992, për kthimin në punë të punëtorëve në punë që janë larguar nga puna nga dt.28.03.1989, deri në përfundim të luftës, dhe se me vendimin e Bordit të drejtorëve të AKP me dt. 11.08.2014 ka filluar procedura e likuidimit të kësaj ndërmarrje, për të cilën i autorizuari i paditësit ka parashtruar kërkesën kreditore për paga të papaguara për periudhën kohore 01.01.1992-11.08.2014, e cila kërkesë është refuzuar nga AL i Likuidimit të NSH “Rekreaturs” për arsye parashkrimi nga neni 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), duke e konsideruar vendimin me shkelje për vërtetim jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike dhe rrjedhimisht ka nxjerr konstatime të gabuara, se ankuesi është larguar nga puna gjatë zbatimit të masave të dhunshme, se a paditura nuk ka shqyrtuar vendimin e Tubimit të punëtorëve dt. 11.08.1999, me të cilin anulohen vendimet e NSH të marra gjatë viteve të 90-ta për ndërprerje të marrëdhënies së punës. Ndërsa për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, thekson se si rrjedhojë e konstatimit jo të plotë dhe të gabuar të gjendjes faktike, e paditura në mënyrë të gabuar ka zbatuar të drejtën materiale, në mënyrë që fare nuk ka zbatuar dispozitat ligjore që rregullojnë gjendjen faktike, duke cituar nenin 608 të Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), me konstatime të dhëna nga vetë përfaqësuesi i ankuesit lidhur me Ligjin 04/L-034 të APK, Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ77/88), Ligjit për ndryshim plotësimet të Ligjit mbi Ndërmarrjet (GZ40/89); (GZ46/90); (GZ60/91), dh Ligjit të Punës së Bashkuar e duke citua dispozitat të këtyre ligjeve, si dhe duke pretenduar për diskriminim në shkelje të të drejtave të njeriut nga marrëdhënia e punës e duke cituar më tej ligje e vendime të gazetës zyrtare të Serbisë, si dhe duke cituar Ligjin kundër Diskriminimit nr. 2004/3, me dispozita ligjore si dhe praktikën gjyqësore të DHPGJS, si dhe duke dhënë konstatime lidhur me pretendimet se paraqet gjendje të jashtëzakonshme dhe është bërë suspendimi i legjislacionit bazik për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut përfshirë të drejtat nga marrëdhënia e punës, dhe se pas përfundimit të luftës në Kosovë qershor 1999, shumicës së punëtorëve të larguar nga puna viteve të 90-ta, NSH-ja, ua ka njohur të drejtën e ke kthimit në punë që konsiderohet anulim i vendimeve mbi largimin nga marrëdhënia e punës dh se kompensimin i pagave të papaguara duhet të konsiderohet sipas bazës së diskriminimit, sikur punëtorët të realizonin të ardhura nëse nuk do të ishin larguar nga puna, duke cituar frymën e KEDNj-së dhe praktikës së DhPGJS-së.

Padisë së tij, ia ka bashkangjitur provat kopje siç janë: Vendimin e AL-së, PRN169-0010 të dt.14.05.2015, librezën e punës, procesverbalin e Mbledhjes së Punëtorëve të NSH “Rekreatus), dt. 11.08.1999, njoftimin e lëshuar nga AKP, dt.23.07.2014, kërkesën e paditësit dt.30.09.2014 dhe autorizimin.

Me dt.01.08.2017, e paditura AKP-ja, ka parashtruar, mbrojtjen e saj në ankesën e paraqitur nga pala paditëse ndër të tjera ka theksuar se me rastin e vendosjes, Autoriteti i Likuidimit, ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat e zbatueshme janë zbatuar saktë, duke theksuar rregullin bazik të procedurës civile kontestimore sipas të cilit pala kërkuese (parashtruesi) ka detyrimin dhe barrën e provës (neni 7 i Ligjit mbi Procedurën Kontestimore dhe neni 23 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 033) e veçmas duke u bazuar në dispozitën e nenit 23.2.4 dhe 23.3 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në, se parashtruesi pretendon se AL ka bërë vlerësim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike duke ofruar nja ankesë me historik të zhvillimeve të NSH gjatë viteve 1990-1999, se AL-ja, nuk ka shqyrtuar fare se, si parashtruesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës dhe nuk ka marrë parasysh vendimin e Tubimit të punëtorëve dt,11.08.1999, dhe se kërkesa i referohet kompensimit për paga të papaguara nga 01.01.1992-11.08.2014, kur NSH hyri në likuidim, për të cilën AL konstatoi se kërkesa për kompensim është parashkruar sipas nenit 36.2 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP që parashikon se “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”, dhe sipas nenit 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), sepse parashtruesi nuk ka ndërmarr ndonjë veprim ligjor për të kërkuar pagat brenda periudhës tre vjetarë të parashkrimit nga viti 1992, duke e konsideruar kërkesën si të parashkruar duke theksuar se praktikën e DHPGJS me aktvendimet e saj., se kërkesa është hipotetike, dhe se parashtruesi nuk ka paraqitur asnjë provë për të dëshmuar bazën e kërkesës për kompensim për paga, duke kundërshtuar edhe pretendimet e parashtruesit për viktimitë të diskriminimit nga organi i dhunshëm serb, duke e deklaruar se ky pretendim nuk ka ndonjë relevancë sa i përket vendimit të AL, pasi që parashtruesi duhej të ketë ndjekur çështjen në Gjykatën e Punës së Bashkuar në atë vit, parashtruesi ka renditur një sërë aktesh, pa relevancë në lidhje me çështjen dhe se pretendimet lidhur me Ligjin mbi Diskriminim nr.2004/3, ka hyrë në fuqi më 2004 dhe nuk ka asnjë lidhje me periudhën e kërkesës. Në përfundim i paraqet gjykatës që të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe vërtetohet Vendimi i AL-së.

Më dt. 22.11.2023, i autorizuari i paditësit av. Isufi, ka paraqitur përgjigje në mbrojtjen dhe kërkesë për caktimin e seancës gjyqësore, duke kundërshtuar qëndrimet e paditurës lidhur me parashkrimin, dhe duke përsëritur qëndrimet e paraqitura edhe në parashtrësat e mëparshme, një ashtu edhe propozimin për marrjen e aktgjykimit, duke theksuar se e paditura fare nuk e ka shqyrtuar vendimin e Tubimit të Punëtorëve dt.11.08.1999, dhe se gjykata duhej të kishte parasysh faktin se përfaqësuesit e AKP-së, ishin njoftuar me dt. 11.09.2003, se objekti i “Rekreaturs”, ishte uzurpuar, andaj kjo i pamundësoj paditësin që të krijonte të hyra dhe pagat e rregullta, e po ashtu i ka kërkuar gjykatës që të caktoj seancë dëgjimore.

Me dt.08.09.2017, e paditura, AKP-ja, ka parashtruar kundërpërgjigjee duke iu referuar përkufizimeve në mbrojtje e me propozimin që gjykata të refuzojë ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar dhe vërtetohet Vendimi i AL-së.

Arsyetimi ligjor:

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par. 1 pika 1 të Ligjit Nr.06/L - 086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGjSK) për Çështjet që Lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit për Dhomën e Posaçme, lidhur me nenin 399 të Ligjit të Procedurës Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet dhe provat që i përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe gjykata merr aktgjykim, pa caktuar seancës dëgjimore.

Po ashtu në nenin 76 paragrafi 3 i Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK), parashihet se: *“Në interpretimin dhe zbatimin e këtij ligji, kudo që është e nevojshme për të zgjidhur një çështje procedurale që nuk trajtohet mjaftueshëm me këtë ligj, Dhoma e Posaçme do të zbatojë mutatis mutandis dispozita përkatëse të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore”* derisa sipas nenit 7 par. 1 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, parashihet se : *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”*.

Pas shqyrtimit të të gjitha shkresave të lëndës, si dhe pretendimeve të palëve në procedurë, gjykata vlerësoj se në rastin konkret, kërkesëpadia e paditësit, duhet të refuzohet si e pabazuar.

Pranueshmëria dhe afatshmëria e kërkesës së paditësit.

Gjykata, ka shqyrtuar provat të cilat i kanë ofruar palët ndërgjyqës, dhe ka konstatuar se NSH “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), me dt. 11.08.2014, ka hyrë në procedurën e likuidimit, ndërsa parashtruesi – tani paditësi me dt.10.02.2014, ka parashtruar kërkesën me pretendimin për kompensimin e pagave të ta papaguara për periudhën 01.01.1992-11.08.2014, në shumë prej 15.470.00 euro + 10 % kamatë, tani në shumë të përgjithshme 17.017.00 euro, e cila kërkesë është refuzuar me vendimin, PRN169-0010 të dt.14.05.2015, të lëshuar nga Autoriteti i Likuidimit në kuadër të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) lidhur me NSH “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), duke e konsideruar si të pavlefshme, dhe se pas pranimi të këtij vendimi pas dt.15.06.2015 kundër këtij vendimi, ankuesi-paditësi, pranë DhPGjSK-së, ankesën – padinë e ka paraqitur me dt.10.06.2014, andaj e njëjta padi, pranë e DhPGJSK-së, është bërë brenda afatit të paraparë ligjor prej 30 ditëve pas ditës së pranimi të Vendimit të kontestuar të AL-së, PRN169-0010 të dt.14.05.2015 dhe se kësaj padie/ankes, ia ka bashkangjitur, vendimin e kontestuar të AL-së.

Gjykata, vlerëson se padia e paditësit i plotëson kriteret e pranueshmërisë dhe afatshmërisë në aspektin procedural nga dispozitat ligjore nga neni 36 dhe 74 I Ligjit Nr.06-L-086 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DHPGJSK) lidhur me nenin 37 par.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në.

Faktet kontestuese dhe jo kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse.

Gjykata vlerëson se në mes palëve ndërgjyqëse, nuk është kontestuese se paditësi me të paditurën, NSH “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), kanë pasur raport të marrëdhënies së punës nga dt. 09.05.1987 – 30.11.1993, dhe atë sipas Librezës së punës me nr. Ser.71180, kur iu është ndërprerë marrëdhënia e punës nga masat e dhunshme sipas pretendimeve të paditësit, dhe se nuk është kontestuese se ekziston një procesverbal i

dt. 11.08.1999 i Tubimit të punëtorëve të NSh, “Rekreaturs” me seli në Prishtinë por kontestuese mbetet çështja e bazës ligjore lidhur në pretendimin e paditësit për të kërkuar pagat e papaguara për periudhën 01.01.1992-11.08.2014, në shumë prej 15.470.00 euro + 10 % kamatë, tani në shumë të përgjithshme 17.017.00 euro, për të cilën paditësi pretendon se ka të drejtë që të kërkojë nga e paditura, NSh “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), si dhe se kërkesën për këto paga a e ka bërë brenda afatit të paraparë ligjor për paraqitjen e saj .

Në rastin konkret, gjykata ka konstatuar se kërkesa e paditësit, ka të bëjë me kërkesat e pa siguruara për pagat e të parapara si lloj i kërkesave, në nenin 40 par.1 pika 1.7 të Shtojcës së Ligjit, Nr.04/L – 034 për AKP-në e në të cilin, parashihet se : *“Në procedurat e likuidimit të gjitha kërkesat e kreditorëve do të përmbushen në pajtim me kategoritë 1.1 – 1.8 më poshtë dhe sipas renditjes në vijim: ... kërkesat e pa siguruara, përfshirë Kërkesat për paga që nuk janë subjekt i trajtimit me prioritet më të lartë”*. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – civile, padinë/ankesën e paditësi të ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN169-0010të dt.14.05.2015 për NSh “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 01.01.1992-11.08.2014, tani në shumë të përgjithshme 17.017.00 €, duhet t’a refuzojë si të pabazuar.

Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se kërkesa e tij në procedurën e likuidimit gjegjësisht nga Autoriteti i Likuidimit, duhet të pranohet sipas kërkesës së tij, pasi që AL-ja, me rastin e refuzimit si të pa vlefshëm të kërkesës së paditës, ka zbatuar dispozitat nga neni 36.2 i Shtojcës së Ligjit, Nr.04/034 për AKP-në, që parashikon se “elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një Kërkese apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë ... kërkesa apo pretendimi është i pas afatshëm sipas kufizimeve kohore të aplikueshme”, dhe nga neni 608 i Ligjit të Punës së Bashkuar (1976), i aplikueshëm sipas neni 1 të Rregullores së UNMIK 1999/24, parashikon që :“pagesa e shumës së pagës apo rrogës apo secilës kërkesë tjetër të punëtorit që rrjedh nga marrëdhënia e punës parashkruhet për tre vjet”, për të cilën gjykata gjen se me rastin e zbatimit të dispozitave ligjore AL-së, drejtë, ka zbatuar dispozitat lidhur e parashkrimin por zbatimi i gabuar i dispozitave ligjore nga AL-ja, nuk i jep të drejtë paditësit në realizimin pretendimeve të tij, pasi që kërkesa e paditësit duhet të bazohet në fakte dhe prova të besueshme se kërkesa e pretenduar për paga të papaguara duhet të mbështet në fakte dhe prova të besueshme ligjore, për të paditësi nuk i ka paraqitur gjykatës.

Gjykata gjen se adresimi i njoftimit nga AKP-ja, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, është njoftim i përgjithshëm për secilin kreditor të mundshëm që në procedurë të likuidimit mund të parashtrij kërkesë eventuale për kompensim, ndërsa sa ai përket procesverbalit në vendimin e Tubimit të punëtorëve dt.11.08.1999, me të cilin anulohen vendimet e NS-së të marra gjatë viteve të 90-ta për ndërprerje të marrëdhënies së punës, kjo gjykata nuk mund t’i marrë si të mundshme të realizueshme, meqë pasi këto vendime të marra në këtë mbledhje të Tubimit të punëtorëve mund të kishin efekt për zbatim me rastin rifillimit të ushtrimit të veprimtarisë së NSh-së, por nuk mund të merret si e bazuara edhe në pretendimin për realizimin e kërkesave për të cilën asnjë herë më parë parashtruesi nuk kërkuar para autoriteteve kompetente të kohës, që gjykata mund të konsideronte këtë kërkesë si të bazuar, për të cilën paditësi edhe për pretendimet për periudhën pas vitit 1999, nuk e ka bërë të besueshme me fakte dhe prova se rifilluar marrëdhënien e punës në ushtrimin e veprimtarisë, të theksuar edhe vetë nga i autorizuari i paditësit në parashtruesin 23.11.2017, se kjo gjykatë duhej të kishte parasysh faktin se përfaqësuesit e AKP-së, ishin njoftuar me dt. 11.09.2003, se objekti i “Rekreaturs”, ishte uzurpuar, andaj kjo i pamundësoj paditësin që të krijonte të hyra dhe pagat e rregullta, për të cilën gjykata gjen se ky arsyetim në pretendimin e paditësit është fakt vendimtar, se paditësi në

vetë deklarimin e tij dëshmon se nuk ka qenë aktiv në marrëdhënies të punës me të paditurën NSh “Rekreaturs” me seli në Prishtinë, si dhe se librezja e tij e punës, është mbyllur me dt.30.11.1993 dhe për këto arsye, nuk mund të jetë e besueshme se paditësi, ka të drejtë në kërkesën e pretenduar për paga të pa paguara. dhe nuk ka asnjë lidhshmëri faktike dhe ligjore se i njëjti është inkuadruar në punë, të kenë punuar dhe mos të kenë realizuar paga për shërbimin në punën e ofruar për NSh-në, për të cilën paditësi, nuk i bënë të besueshme pretendimet e paraqitura në ankesë - padi.

Paditësi edhe para gjykatës, nuk ka paraqitur ndonjë dëshmi në kërkesën e tij që do të bënte të besueshme se kërkesa e parashtruesit, nuk është vlerësuar drejtë nga AL-ja, me rastin e vendosjes. Baza e kërkesës dhe shuma e mjeteve të kërkuara në këtë procedurë duhet të mbështetet plotësisht me provat përkatëse të besueshme. Andaj gjykata konstaton se kërkesën mbi bazën e fakteve të paraqitura të paditësit para AL dhe tani para gjykatës nuk mund të marrë si të besueshme në aprovimin e kërkesës gjegjësisht ankesës së palës, në shqyrtimin e mëtejme të fakteve vendimtare lidhur me provat e prezantuara ka gjetur se me Vendimin e tij, PRN169-0010 të dt.14.05.2015 për NSh “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim) lidhur me kërkesën e paditësit për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën e pretenduar, AL-ja, drejtë ka vepruar me rastin e refuzimit të kërkesës, Pra, në këtë kuptim, ankuesi ka dështuar që të parashtronte prova në mbështetje të kërkesës së tij, pra i njëjti, nuk ka arritur që të parashtronte fakte dhe prova në mbështetje të kërkesës së tij dhe se për këtë arsye, gjykata gjenë se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të papaguara nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Vlerësimet përfundimtare të çështjes nga ana e gjykatës

Gjykata pas administrimit të provave dhe konstatimit të gjendjes faktike, vlerëson se, qëndrimi i të paditurës në refuzimin e kërkesës së parashtruesit për kompensim për pagat të papaguara për periudhën e pretenduar, është i drejtë kur me Vendimin e tij, PRN169-0010 dt.14.05.2015, AL-ja, kur kërkesëne paditësit, e ka vlerësuar si të pavlefshme sepse ky qëndrim bazohet edhe në obligimet e palëve në procedurë se në rastin kur pala pohon të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi, dhe Pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtruesat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese) dhe se neni 42.3 i Ligjit nr. 06/L – 086, në mënyrë shprehimore citon se “... Nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”, se në rastin konkret, pala paditëse nuk ka paraqitur para kësaj gjykate vendim marrëse. Andaj gjykata pasi që bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjitha së bashku, arriti në përfundim se në këtë çështje juridiko – kontesimore, kërkesëpadia e paditësit e ushtruar kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (AL), PRN169-0010 të dt.14.05.2015 për NSh, “REKREATURS” me seli në Prishtinë (në likuidim), për kompensimin e pagave të papaguara për periudhën 01.01.1992 - 11.08.2014, tani në shumë të përgjithshme 17.017.00 euro për kompensimin për paga të papaguara në shumën e pretenduar, është e pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv.

Gjykata ka shqyrtuar edhe pretendimet tjera të palëve ndërgjyqëse, por të njëjtat ishin pa efekt në vendosjes ndryshe të kësaj çështje juridike, dhe nuk e konsideron të nevojshme të japë arsyetime tjera ligjore.

Prandaj nga ajo që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 4 par.9, nenit 9, nenit 54 par.1 dhe nenit 74 par.4 të Ligjit nr. 06/L - 086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës (DhPGJSK).

Shpenzimet Gjyqësore

Në bazë të nenin 62 par. 5 të Ligjit nr. 06/L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, gjykata vendosi që secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS 2022:281655, 23.02.2024

**Gjykatësi
Agron Hoxhaj**

KËSHILLË JURIDIKE :

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme dhe atë brenda **15 (pesë mbëdhjetë) ditëve** pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës.